

UNIVERSITETI “ISA BOLETINI” NË MITROVICË

Fakulteti i Teknologjisë Ushqimore



PLANI STRATEGJIK

2024 - 2026

Emërtimi i shkurtesave të përdorura në material

GE	Grupi i ekspertëve
IAL	Institucion i Arsimit të Lartë
KD	Këshilli Drejtues
KP	Komisioni profesional
KQSCV	Komisioni Qendror për Sigurimin e Cilësisë dhe Vlerësimit
FTU	Fakulteti i Teknologjisë Ushqimore
MASHTI	Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit
NJA	Njësitë Akademike
PA	Parlamenti Studentor
PSUIBM	Plani Strategjik i Universitetit “Isa Boletini”, Mitrovicë
PSFTU	Plani Strategjik i Fakultetit të Teknologjisë Ushqimore
SA	Stafi akademik
SI	Sistemi informativ
TI	Teknologjia informative
UIBM	Universiteti “Isa Boletini”, Mitrovicë
ZBN	Zyra për Bashkëpunim Ndërkombëtar
ZÇA	Zyra për Çështje Akademike
ZSC	Zyra për Sigurim të Cilësisë

HARTIMI I PLANIT STRATEGJIK

Këshilli i FTU-së në mbledhjen e mbajtur me datën 08.12.2023, me vendimin numër prot. 555, vendosi për emërimin e Komisionit Profesional për hartimin e dokumentit Plani Strategjik i FTU-së për periudhën kohore 2024-2026. Nga data e miratimit të këtij dokumenti të gjitha aktivitetet zhvillimore të FTU-së do të udhëhiqen nga ky dokument i cili njëkohësisht do të jetë edhe tregues i performancës së strukturave menaxhuese të FTU-së mbi bazën e monitorimit dhe rishikimit vjetor të tij.

Këshilli i Fakultetit ka emëruar Komisionit profesional me këtë përbërje:

- Prof. ass. dr. Mirsade Osmani, kryetare
- Prof. asoc. dr. Mensur Kelmendi, anëtar
- Prof. asoc. dr. Mehush Aliu, anëtar
- Prof. dr. Alush Musaj, anëtar
- Prof. asoc. dr. Fatos Rexhepi, anëtar
- Prof. ass. dr. Bahtir Hyseni, anëtar
- Prof. ass. dr. Faruk Hajrizi, anëtar
- Dr.sc. Arbër Hyseni, anëtar
- Dr.sc. Dafina Llugaxhiu, anëtare
- Merita Fazlija, anëtare
- Eranda Haxhnikaj, anëtare
- Blend Broqi, anëtar
- Fjolla Lasku, anëtare

Plani strategjik 2024-2026 i FTU-së është hartuar mbështetur në Standardet e Udhëzimeve për Sigurimin e Cilësisë në UIBM dhe në Zonën Evropiane të Arsimit të Lartë, Ligji 04/L-037 për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës, Statutin e Universitetit "Isa Boletini" në Mitrovicë, Udhëzimet nga Agjencia e Kosovës për Akreditimit (AKA), Planin strategjik të UIBM 2022-2025 dhe Rekomandimet e Grupit Ndërkombëtar të Ekspertëve si dhe bazuar në ekzaminimi dhe analizen e trendeve bashkëkohore.

Ky dokument përfaqëson synimin tonë për avancimin e Fakultetit të Teknologjisë Ushqimore si në substancë ashtu edhe në reputacion.

Fjala e dekanit

Plani ynë strategjik është më shumë se një dokument i thjeshtë. Ky është një dokument i aspiratave, vlerave dhe angazhimeve tona kolektive. Si i tillë pasqyron përkushtimin tonë të palëkundur ndaj përsosshmërisë akademike, inovacionit në hulumtimin shkencor dhe ndikimin e tij në shoqëri për të adresuar sfidat e kohës sonë.

Ky plan strategjik është shkruar duke u mbështetur mbi arritjet tona të së kaluarës dhe mësimet që janë nxjerrur nga ajo. Ne kemi bërë një rrugë të gjatë, duke kapërcyer pengesat dhe duke shfrytëzuar mundësitë në rrugën e zhvillimit të mëtutjeshëm.

Bota rreth nesh po evoluon me një ritëm të paparë, duke na paraqitur sfida dhe mundësi të reja, prandaj ne duhet të jemi të guximshëm, vizionarë dhe të synojmë sa më lart. Ne duhet të shfrytëzojmë pikat tona të forta, të zbusim dobësitë tona, të shfrytëzojmë mundësitë dhe të përballemi me sfidat tona të reja.

Prioritetet tona kryesore në planin strategjik rezonojnë me misionin, vizionin dhe vlerat e fakultetit tonë. Përveç përmirësimit të programeve tona aktuale të studimit, hartimit të programeve të reja studimore, nxitja e bashkëpunimeve ndërdisiplinore, avancimi në fushën e hulumtimit, forcimi i bashkëpunimeve tona me institucione kombëtare dhe ndërkombëtare, me industrinë dhe komunitetin do të jenë synimi ynë. Në këtë drejtim, secili prej nesh ka kontribuar në ndërtimin e të ardhmes së fakultetit tonë si: stafi akademik, studentët, të diplomuarit, stafi administrativ si dhe partnerët nga industria.

Së bashku, ne treguam se kemi fuqinë për të transformuar vizionin tonë në realitet - për të krijuar një të ardhme ku fakulteti ynë qëndron në ballë të sukseseve dhe ndikimit shoqëror. Le të shfrytëzojmë këtë mundësi për të formësuar fatin tonë dhe për të lënë një trashëgimi të qëndrueshme për brezat që do të vijnë.

Në mbyllje, shpreh mirënjohjen time të përzemërt për secilin prej jush për përkushtimin, punën me pasion për zhvillimin e fakultetit tonë, tejkalimin e sfidave dhe gatishmërinë për të përqaftuar diversitetin e mendimit të secilit prej nesh.

Faleminderit.

Prof. asoc.dr. Mensur Kelmendi

1. Përshkrim i shkurtër i zhvillimit të Fakultetit të Teknologjisë Ushqimore

1.1 Historiku i zhvillimit të Fakultetit të Teknologjisë Ushqimore

Zhvillimi i Fakultetit të Teknologjisë Ushqimore është i lidhur me hapjen e Shkollës së Lartë Teknike në vitin 1961 në Mitrovicë. Në këtë shkollë janë përgatitur inxhinierë për Xehetari, Metalurgji dhe Teknologji. Studimet kanë zgjatur dy vjet. Në vitin 1970 në kuadër të Fakultetit Teknik të Universitetit të Prishtinës hapen degët e Teknologjisë, Xehetarisë dhe Metalurgjisë, fillimisht në Mitrovicë, viti akademik 1970/71, për të vazhduar pastaj në Prishtinë deri në themelimin e Fakultetit të Xehetarisë dhe Metalurgjisë në Mitrovicë. Me vendimin e Kuvendit të Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, me 22 korrik 1974 themelohet Fakulteti i Xehetarisë dhe Metalurgjisë në Mitrovicë, në kuadër të të cilit është edhe drejtimi i Teknologjisë. Prej vitit akademik 2008/2009 përveç studimeve Bachelor organizohen edhe studimet Master sipas Bolojnës. Në vitin 2011, me vendimin e Këshillit Drejtues të Universitetit të Prishtinës, ndërrohet emërtimi i fakultetit, nga Fakulteti i Xehetarisë dhe Metalurgjisë në Fakultetin e Gjeoshkencave dhe Teknologjisë. Me themelimin e Universitetit “Isa Boletini” në Mitrovicë, Fakulteti i Teknologjisë vazhdon me një plan dhe program të ri dhe me emërtim të ri, Fakulteti i Teknologjisë Ushqimore.

1.2 Fakulteti i Teknologjisë Ushqimore sot

Universiteti “Isa Boletini në Mitrovicë” është themeluar me vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës, nr. 01/118 dt. 06.03.2013 dhe me ratifikim të këtij vendimi nga Parlamenti i Republikës së Kosovës me 31.05.2013. Mbi bazën e këtij vendimi është themeluar edhe Fakulteti i Teknologjisë Ushqimore.


Aktivitetet e fakultetit përfshijnë arsimin e lartë, ofrimin e studime bachelor dhe master në programet e studimit Inxhinieri dhe Teknologji Ushqimore si dhe Teknologji me specializimet Inxhinieri Kimike dhe Inxhinieri e Mbrojtjes së Mjedisit po ashtu edhe kërkimet shkencore në fushat përkatëse.



Objekti ku zhvillon veprimtarinë FTU

Te gjitha aktivitetet e fakultetit zhvillohen në hapësirat e fakultetit me një sipërfaqe prej 11000 m², me 15 laboratore, 6 salla të mësimit me 15 profesorë dhe 3 asistentë.

Në bazë të Statutit të UIBM, Fakultetit i Teknologjisë Ushqimore funksionon me këtë strukturë organizative:



Programet e ofruara të studimit në nivelin Bachelor dhe Master

Fakulteti i Teknologjisë Ushqimore	Programet studimore	Niveli i studimeve	I akredituar prej	I akredituar deri më
1.	Teknologji	BSc	01.10.2022	30.09.2025
2.	Teknologji	MSc	01.10.2022	30.09.2025
3.	Inxhinieri dhe Teknologji Ushqimore	BSc	01.10.2022	30.09.2025
4.	Inxhinieri dhe Teknologji Ushqimore	MSc	01.10.2024	30.09.2029

Vizioni i FTU

Përkushtimi ndaj përsosshmërisë në mësimdhënie dhe hulumtim shkencor, në zhvillimin e qëndrueshëm të teknologjisë, shkencës, industrisë dhe shoqërisë në përgjithësi. Fakulteti i Teknologjisë Ushqimore synon një të ardhme ku stafi i fakultetit dhe studentet pasqyrojnë diversitetin socioekonomik, gjinor dhe racor të shoqërisë. Të diplomuarit tanë do të vlerësohen për përkushtimin dhe entuziazmin e tyre në punë, sjelljen etike, integritetin si dhe aftësinë për të punuar në grupe.

Misioni i FTU

Të ofrojë mësimdhënie cilësore për përgatitjen e kuadrove në fushat Inxhinieri dhe Teknologji Ushqimore si dhe në fushën e Inxhinierisë së mjedisit për Kosovën dhe rajonin, i dedikuar të ofrojë kërkime shkencore, këshillime profesionale dhe veprimtari të tjera profesionale që sigurojnë mirëqenie dhe avancim shoqëror.

Vlerat mbi të cilat mbështetet veprimtaria e Fakultetit të Teknologjisë Ushqimore dhe mbi të cilat është hartuar Plani Strategjik 2024-2026 udhëhiqen në drejtim të përmbushjes së misionit dhe vizionit të tij. Fakulteti promovon vlerat universale, grupore dhe individuale, të cilat janë:

- *Drejtësia*
- *Liria akademike*
- *Përgjegjësia*
- *Respektimi i ndërsjellë*
- *Integriteti*
- *Diversiteti*

Palët e interesit

Zhvillimi strategjik i FTU-së për periudhën 2024-2026, planifikohet të zbatohet në bashkëveprim dhe bashkëpunim të ngushtë me të gjitha palët e interesit. Resurset humane paraqesin pasurinë më të rëndësishme të universitetit dhe fakultetit tonë andaj, personeli akademik, administrativ dhe teknik, si dhe menaxhmenti i universitetit dhe fakultetit janë listuar më së larti në grupin e palëve të interesit.

Personeli akademik - janë bartësit kryesorë të procesit mësimor efektiv, këshillimit akademik dhe këshillimit të studentëve, si dhe janë përgjegjës për zhvillimin e vazhdueshëm të kurrikulës përmes vlerësimit, veprimtarisë studimore, kërkimit shkencor dhe bashkëpunimit ndërkombëtar. Në këtë grup interesi përfshihen profesorët e rregulltë, profesorët e angazhuar, asistentët dhe bashkëpunëtorët shkencor. Sipas thirrjes akademike, personeli akademik ka këtë përbërje: Prof. dr., Prof. asoc. dr., Prof. ass. dr., Ass. dhe Ligjërues.

Personeli administrativ dhe teknik - përbëjnë palët e brendshme të interesit të cilët kryejnë funksionet operacionale dhe administrative të universitetit dhe fakultetit, administrimin e fakulteteve dhe departamenteve, marrëdhëniet me publikun dhe marketingun si dhe shërbimet studentore. Në këtë grup interesi përfshihen: sekretari i përgjithshëm dhe sekretarët e njësive akademike, drejtorët e zyrave, zyrtarët e administratës, bibliotekistët dhe personeli teknik.

Menaxhmenti i Fakultetit - Menaxhmenti i Fakultetit përbën organet udhëheqëse dhe vendim-marrëse që përkujdesen për menaxhimin dhe mbarëvajtjen e punës edukative, kërkimit shkencor, sigurimit të cilësisë, bashkëpunimit ndërkombëtar si dhe menaxhimin financiar. Në këtë grup interes i bëjnë pjesë: Dekani, Prodekanët, Shefi i Departamentit, Këshilli i Fakultetit.

Studentët - Studentët paraqesin palën më thelbësore të interesit për zhvillimin e Fakultetit. Sukses i karrierës postakadematike të studentëve reflekton në fakultetin ku ata kanë vijuar studimet, andaj, studentët konsiderohen pala kryesore e interesit në Fakultet. Vlerësimet dhe sygjerimet e studentëve paraqesin forcat lëvizëse drejt suksesit të përgjithshëm të Fakultetit. Këtë grup të interesit e përbëjnë studentët e rregullt nga të gjitha trevat e Kosovës.

Alumni - janë studentët e diplomuar, të cilët Fakulteti i sheh si një aset të pashmangshëm dhe të një rëndësie të veçantë. Fakulteti në kuadër të universitetit ka themeluar Shoqatën Alumni, e cila shërben si urë lidhjeje në mes studentëve aktual, personelit akademik dhe administrativ, Alumnit, si dhe komunitetit të jashtëm. Fakulteti vazhdon ofrimin e shërbimeve ndaj këtij grupi të interesit, si dhe i mban të informuar dhe të interesuar për zhvillimin e vazhdueshëm të fakultetit dhe mundësive për bashkëpunim.

Komuniteti i biznesit - përbëhet nga përfaqësuesit e industrisë, Oda Ekonomike e Kosovës, bizneset lokale, por dhe ato ndërkombëtare, dhe paraqet palë strategjike të interesit. Me qëllim të rritjes së bashkëpunimit me këtë palë interes, Fakulteti ka themeluar Bordin Këshilldhënës.

Autoriteti qeveritar lokal dhe qendror - në këtë grup të palës së interesit përfshihen përfaqësuesit e Kuvendeve Komunale të rajonit të Mitrovicës, MASHTI-i, AKA, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve Ministria përgjegjëse për Administratë Publike, etj. Ky grup ka rëndësi mjaft të madhe drejt zbatimit të Planit Strategjik të Fakultetit, por edhe në historikun dhe zhvillimin e universitetit, si dhe Arsimit të Lartë në përgjithësi.

Komuniteti i jashtëm akademik dhe shkencor - përbëhet nga partnerët e jashtëm strategjik të Fakultetit. Këtij grupi i takojnë Fakultete bashkëpunuese në Kosovë dhe jashtë, Institutet Kërkimore-Shkencore dhe institucionet e tjera, të cilat e ndihmojnë fakultetin në ngritjen e kapaciteteve akademike, kërkimore dhe shkencore.

2. Objektivat afatgjate (2024-2026)

Ofrimi i infrastrukturës moderne

- Ngritja e infrastrukturës që është e favorshme për kryerjen e veprimtarive Hulumtim dhe Zhvillim
- Infrastruktura ekzistuese do të ri-orientohet për të qenë në përputhje me kërkesat më të reja.

Bashkëpunimi me institucionet kombëtare dhe ndërkombetare të arsimit të lartë

- Bashkëpunimi me universitetet dhe institucionet e huaja me reputacion për kërkime, projekte shkencore, botime dhe konferenca
- Krijimi i mundësive për shkëmbimin e stafit të fakultetit dhe studentëve

Përmirësimi i procesit mësimor

- Të mësuarit përmes përvojës si dhe të mësuarit bazuar në projekte
- Përdorimi efektiv i klasës hibride si sistem më i avancuar që kemi për të mësuar më mirë rreth mësimit eksperimental.

Zgjerimi i bashkëpunimit me sektorin publik dhe atë privat për të zhvilluar projekte dhe kërkime shkencore të lidhura drejtperdrejt me këta sektorë për të arritur përfitime financiare për fakultetin si dhe për realizimin e praktikës profesionale si pjesë e integruar e kurrikulës për studentë. Vitet e fundit, stafi i fakultetit ka qenë shumë i angazhuar në intensifikimit e bashkëpunimit me sektorin e industrisë përmes zbatimit të projekteve profesionale, realizimit të marrëveshjeve të bashkëpunimit, si dhe përmes shërbimeve konsulencë. Fakulteti posedon kapacitetet dhe kompetencat për bashkëpunim edhe më intensiv me sektorin e industrisë dhe për këtë arsye do të inkurajojë:

- realizimin e projekteve të përbashkëta me industrinë,
- nënshkrimin e marrëveshjeve të reja për bashkëpunimin me sektorin e industrisë,
- nënshkrimin e marrëveshjeve të reja me kompanitë që shërbejnë si baza akademike të Fakultetit
- ngritjen e programeve të reja të të mësuarit gjatë gjithë jetës në përputhje me nevojat e sektorit të industrisë.

SWOT ANALIZA

Faktorët e brendshëm	
Avantazhet/pikat e forta	<ul style="list-style-type: none"> • Përvojë e gjatë në arsimin e lartë, shkencor, kërkimor dhe punë profesionale e stafit akademik • Infrastruktura moderne dhe laboratore hulumtuese te pajisura mirë • Potencial për kërkime ndërdisiplinore • Përvoja individuale e ekipeve kërkimore në aplikimin dhe zbatimin e projekteve financuar nga BE dhe MASHTI • Stafi i ri akademik, shkencor, kërkimor dhe përkrahja financiare në kërkim shkencor nga Universiteti • Numër i konsiderueshëm i mobiliteteve të stafit dhe bashkëpunimi me studiues të huaj dhe vendor • Përfaqësimi i studentëve në të gjitha strukturat vendimarrëse në Fakultet, • Rezultatet vleresuese pozitive të studentëve në pyetësoret e tyre • Bashkëpunim i mirë me operatorët e bizneseve, industrinë ushqimore, organizata për ruajtjen e mjedisit • Aktivitete dhe konsultime me organizatën ALUMNI të fakultetit • Themelimi i Institutit të Teknologjisë Ushqimore dhe Mjedisore • Kosto e ulët dhe e përballeshme e studimit për student.
Disavantazhet/pikat e dobëta	<ul style="list-style-type: none"> • Trajnim i pamjaftueshëm afatgjatë (3 muaj ose më shumë) i stafit akademik në institucione të huaja Universitete ose Institute Kërkimore-Shkencore • Mungesë e buxhetit për të pasë më shpesh profesorë ndërkombëtar, ekspertë të fushës • Numër jo i kënaqëm i publikimeve shkencore • Regjistrimi i studimeve për përfitime financiare (STEM bursa me vlerë 1000 euro nga Qeveria e mandej braktisja e studimeve) • Ngarkesa e stafit me numër më të madh të lëndëve për plotësimin e normës.
Faktorët e jashtëm	
Mundësitë	<ul style="list-style-type: none"> • Bashkëpunimi me universitete të tjera dhe institucione shkencore si dhe nxitja për projekte kërkimore • Rritja e fondeve dhe thirrje për aplikime në projekte shkencore dhe profesionale (grante të BE-së, MASHTI) • Inkurajimi i aplikimeve për projekte ndërkombëtare • Nxitja e veprimtarisë botuese të stafit • Themelimi i programeve të reja të studimit • Organizimi i aktiviteteve promovuese, seminareve, workshop-eve • Bursa për studentë të dalluar nga MASHTI • Pavarësi e plotë institucionale në aspektin operacional, organizativ dhe financiar.
Rreziqet	<ul style="list-style-type: none"> • Emigrimi i të rinjëve • Nivel i ulët i interesimit për projekte kërkimore dhe profesionale • Konkurrenca joleale nga kolegjet private

3. Qëllimet strategjike dhe plani organizativ i zhvillimit të Fakultetit të Teknologjisë Ushqimore

Fushat strategjike të zhvillimit të Fakultetit të Teknologjisë Ushqimore janë:

1. Mësimdhënia dhe studentët,
2. Hulumtimi shkencor,
3. Organizimi, burimet dhe sistemi i sigurimit të cilësisë,
4. Bashkëpunimi

Mësimdhënia dhe studentët

Objektiva strategjike- Përmirësimi dhe ngritja e vazhdueshme e procesit akademik, përmirësimi i programeve aktuale të studimit duke u konsultuar edhe me kërkesat e industrisë dhe tregut të punës si dhe hartimi i programeve të reja të studimit.

Treguesit kryesorë:

1. Numëri i programeve të përmirësuara të studimit
2. Numëri i programeve të reja të studimit

Detyrat:

1. Ngritja e nivelit të cilësisë (përmirësimi) të programeve ekzistuese të studimit, kushtet e studimit
2. Zhvillimi i programeve të reja të studimit në përputhje me nevojat e sektorit të ekonomisë
3. Mbështetjen e zbatimit të punës në terren brenda ciklit të parë dhe të dytë të studimeve

Hulumtimi shkencor

Objektiva strategjike- Ngritja e kapacitetit hulumtues-shkencor si dhe bashkëpunimit dhe bartja e rezultateve hulumtuese tek sektori i ekonomisë

Treguesit kryesorë

1. Numëri i punonjësve të përfshirë në zbatimin e projektit
2. Të ardhurat e mësimdhënësve për zbatimin e projektit
3. Numëri dhe cilësia e publikimeve të botuara në vit për hulumtues shkencor
4. Numëri i citimeve në vit
5. Numëri i projekteve me industrinë

Detyrat:

1. Inkurajimi i aplikimit dhe zbatimit të projekteve shkencore, profesionale dhe infrastrukturore
2. Përcaktimi i prioriteteve shkencore dhe kërkimore të fakultetit
3. Rritja e numërit dhe cilësisë së punimeve shkencore të botuara, të indeksuara në platformen Scopus dhe WoS
4. Zhvillimi i metodave analitike dhe proceseve teknologjike me interes për sektorin ekonomik.

Bashkëpunimi ndërkombëtar

Objektiva strategjike - Pëmirësimi i bashkëpunimit ndërkombëtar dhe me komunitetin e biznesit

Treguesit kryesorë:

1. Numëri i projekteve të përbashkëta ndërkombëtare dhe ndërinstitucionale
2. Numëri i mobiliteteve
3. Numëri i konferencave shkencore
4. Numëri i projekteve të përbashkëta me industrinë

Detyrat:

1. Rritja e nivelit të bashkëpunimit ndërkombëtar të fakultetit, rritja e numërit të mobiliteteve të stafit dhe studentëve dhe lidhja e ekipeve kërkimore dhe institucioneve në projekte të përbashkëta;
2. Inkurajimi i organizimit të konferencave shkencore ndërkombëtare dhe shkollave verore me ekspertë ndërkombëtar;
3. Inkurajimi i stafit të fakultetit për bashkëpunim me institucione shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare;
4. Rritja e bashkëpunimit me institucionet publike, sektorin e industrisë dhe komunitetin lokal;
5. Inkurajimi i stafit të fakultetit për bashkëpunim me komunitetin e biznesit në aplikimin dhe zbatimin e projekteve të përbashkëta;
6. Rritja e pjesëmarrjes aktive të antarëve të ALUMNI në aktivitete të ndryshme të fakultetit.

Organizimi, burimet dhe sistemi i sigurimit të cilësisë

Objektiva strategjike: Rritja e numërit të stafit akademik dhe administrativ si dhe rritja e kapaciteteve shkencore dhe kërkimore të fakultetit.

Treguesit kryesorë:

1. Pajisja e vazhdueshme e laboratoreve me apatatura të reja
2. Numëri i teksteve universitare të botuara
3. Numëri i kurseve për mësimdhënie të avansuar për stafin akademik

Detyrat:

1. Krijimi i mjediseve të reja të nevojshme për punë shkencore dhe mësimore në Fakultetin e Teknologjisë Ushqimore, ngritja e laboratoreve hulumtuese-shkencore si dhe përmirësimi i laboratoreve ekzistuese mësimore;
2. Ofrimi i mbështetjes së nevojshme administrative në fushën e kërkimit si dhe inkurajimi i stafit akademik dhe administrative për mobilitete;
3. Rritja e numërit të teksteve universitare të shkruara nga stafi i FTU-së;
4. Furnizimi me pajisje laboratorike dhe aparatura bashkëkohore dhe me pajisje të IT dhe inkurajimin e përdorimit të programeve kompjuterike, SMU

4. Treguesit e performancës për zbatimin e Planit Strategjik për periudhën 2024–2026

Inkurajimi për aplikimin dhe zbatimin të projekteve profesionale shkencore, infrastrukturore

Treguesit	Vlera e caktuar	Personat përgjegjës	Raportimi	Kohëzgjatja
Numëri dhe vlera e projekte shkencore të financuara nga burime vendase	Në rritje	Stafi i fakultetit	Prodekani për cilësi dhe bashkëpunim nërkombëtar	2024-2026 në krahasim me vitet paraprake
Numëri dhe vlera e projekteve ndërkombëtare	Në rritje	Stafi i fakultetit	Prodekani për cilësi dhe bashkëpunim nërkombëtar	2024-2026 në krahasim me vitet paraprake
Numëri dhe vlera e projekte të financuara nga BE	Në rritje	Stafi i fakultetit	Prodekani për cilësi dhe bashkëpunim nërkombëtar	2024-2026 në krahasim me vitet paraprake
Numëri dhe vlera e projekteve profesionale	Në rritje	Stafi i fakultetit	Prodekani për mësim	2024-2026 në krahasim me vitet paraprake

Rritja e vazhdueshme e sasisë dhe cilësisë së publikimeve shkencore të indeksuara në bazat e të dhënave WoS/CC

Treguesit	Vlera e caktuar	Personat përgjegjës	Raportimi	Kohëzgjatja
Numëri i publikimeve të botuara	Në rritje	Stafi i fakultetit	Prodekani për cilësi dhe bashkëpunim nërkombëtar	2024-2026 në krahasim me vitet paraprake
Numëri i publikimeve të botuarve në Q1 dhe Q2	Në rritje	Stafi i fakultetit	Prodekani për cilësi dhe bashkëpunim nërkombëtar	2024-2026 në krahasim me vitet paraprake
Numëri i citimeve në vit	Në rritje	Stafi i fakultetit	Prodekani për cilësi dhe bashkëpunim nërkombëtar	2024-2026 në krahasim me vitet paraprake

Përmirësimi i njohjes ndërkombëtare të fakultetit, rritja e numërit të mobiliteteve të stafit dhe studentëve, si dhe lidhja e ekipeve kërkimore dhe institucioneve në projekte të përbashkëta

Treguesit	Vlera e caktuar	Personat përgjegjës	Raportimi	Kohëzgjatja
Numërit i marrëveshjeve ndërkombëtare	Në rritje	Stafi i fakultetit	Prodekani për cilësi dhe bashkëpunim nërkombëtar	2024-2026 në krahasim me vitet paraprake
Numëri i mobiliteteve hyrëse dhe dalëse të stafit dhe studentëve të fakultetit	Në rritje	Stafi i fakultetit	Prodekani për cilësi dhe bashkëpunim nërkombëtar	2024-2026 në krahasim me vitet paraprake
Numëri i workshopeve për programet e mobiliteteve	Në rritje	Prodekani për cilësi dhe bashkëpunim nërkombëtar	Prodekani për cilësi dhe bashkëpunim nërkombëtar	2024-2026 në krahasim me vitet paraprake
Numëri i publikimeve të realizuara me hulumtues shkencor nga institucione të huaja	Në rritje	Stafi i fakultetit	Prodekani për cilësi dhe bashkëpunim nërkombëtar	2024-2026 në krahasim me vitet paraprake
Broshura e fakultetit në gjuhën angleze	1	Administrata e fakultetit dhe Shefi i Fakultetit	Prodekani për cilësi dhe bashkëpunim nërkombëtar	2024
Webfaqja e fakultetit	1	Administrata e fakultetit dhe Shefi i Fakultetit	Prodekani për cilësi dhe bashkëpunim nërkombëtar	2024

Inkurajimi i organizimit të konferencave shkencore ndërkombëtare dhe shkollave verore me mësimdhënës nga institucionet e huaja

Treguesit	Vlera e caktuar	Personat përgjegjës	Raportimi	Kohëzgjatja
Numëri i konferencave shkencore dhe shkollave verore	Në rritje	Stafi i fakultetit	Prodekani për mësim; Prodekani për cilësi dhe bashkëpunim ndërkombëtar	2024-2026 në krahasim me vitet paraprake
Numëri i ligjëruesve të huaj, të ftuar	Në rritje	Stafi i fakultetit	Prodekani për cilësi dhe bashkëpunim ndërkombëtar	2024-2026 në krahasim me vitet paraprake

Inkurajimi i bashkëpunimit të stafit të fakultetit me institucione të tjera dhe qendrat shkencore të ekselencës

Treguesit	Vlera e caktuar	Personat përgjegjës	Raportimi	Kohëzgjatja
Fakulteti si institucion partner në një qendër shkencore të ekselencës	Marrëveshje bashkëpunimi	Stafi i fakultetit; Administrata e fakultetit	Prodekani për cilësi dhe bashkëpunim ndërkombëtar; Prodekani për mësim	2024-2026 në krahasim me vitet paraprake
Numëri i projekteve shkencore të përbashkëta të fakultetit me partner të tjerë në qendra shkencore të ekselencës	Në rritje	Stafi i fakultetit	Prodekani për cilësi dhe bashkëpunim ndërkombëtar; Prodekani për mësim	2024-2026 në krahasim me vitet paraprake

Përmirësimi i bashkëpunimit me sektorin e industrisë, institucionet publike dhe komunitetin lokal

Treguesit	Vlera e caktuar	Personat përgjegjës	Raportimi	Kohëzgjatja
Numëri i marrëveshjeve të bashkëpunimit me sektorin e industrisë dhe komunitetin lokal	Në rritje	Stafi i fakultetit	Prodekani për mësim; Prodekani për cilësi dhe bashkëpunim ndërkombëtar	2024-2026 në krahasim me vitet paraprake
Themelimi i komisionit për bashkëpunim me sektorin e industrisë dhe një plan i adaptuar i veprimit	Vendimi	Administrata e fakultetit	Prodekani për mësim; Prodekani për cilësi dhe bashkëpunim ndërkombëtar	2024
Promovimi i aktiviteteve profesionale të fakultetit (media,seminare, forume, aktivitete humanitare, etj.)	Në rritje	Stafi i fakultetit	Prodekani për mësim	2024-2026 në krahasim me vitet paraprake

Përmirësimi i furnizimit me pajisjeve të kërkimit dhe informacionit

Treguesit	Vlera e caktuar	Personat përgjegjës	Raportimi	Kohëzgjatja
Sasia e pajisjeve kapitale	Në rritje	Stafi i fakultetit	Prodekani për mësim; Prodekani për cilësi dhe bashkëpunim ndërkombëtar	2024-2026 në krahasim me vitet paraprake
Pajisjet kompjuterike	Lista përkatëse	Stafi i fakultetit	Prodekani për mësim	2024-2026 në krahasim me vitet paraprake
Infrastruktura për e-learning	Sistemi funksional për e-learning	Administrata e fakultetit dhe përgjegjësi për IT	Prodekani për mësim	2024

Monitorimi dhe Vlerësimi i zbatimit të Strategjisë në Fakultetin e Teknologjisë Ushqimore

Për Fakultetin e Teknologjisë Ushqimore, implementimi i një strategjie të suksesshme është i lidhur ngushtë me proceset e monitorimit dhe vlerësimit të vazhdueshëm. Ky proces është i domosdoshëm për të siguruar se objektivat e përcaktuara në Planin Strategjik do të realizohen dhe do të kontribuojnë në zhvillimin dhe përmirësimin e cilësisë në fushën e mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe zhvillimit të industrisë ushqimore dhe asaj të mjedisit.

Fakulteti do të krijojë Grupin për Koordinimin dhe Monitorimin e zbatimit të Planit Strategjik, i cili do të drejtohet nga një koordinator i emëruar nga Këshilli i Fakultetit. Ky grup do të ketë disa detyra kyçe:

1. Hartimi i planeve të veprimit për periudha gjashtëmujore, të cilat do të fokusohen në arritjen e objektivave të caktuara për zhvillimin e kurrikulave dhe programeve të reja në fushën e teknologjisë ushqimore dhe të mbrojtjes mjedisore;
2. Monitorimi i progresit të zbatimit të Planit Strategjik duke analizuar të dhënat e mbledhura nga departamentet përkatëse dhe duke vlerësuar përparimin e aktiviteteve të zhvilluara.
3. Vlerësimi i burimeve financiare, duke siguruar që fondet e dedikuara për kërkime dhe përmirësimin e infrastrukturës të përdoren në mënyrë efikase.
4. Propozimi dhe miratimi i masave korigjuese, për të adresuar çdo sfidë që mund të lindë gjatë zbatimit të strategjisë.

Përgjegjësitë e Këshillit të FTU-së

Këshilli i FTU-së do të ketë përgjegjësinë për mbikëqyrjen e implementimit të strategjisë. Raportet e përgatitura nga Grupi për Koordinimin dhe Monitorimin do të shqyrtohen nga ky këshill për të siguruar që qëllimet janë në proces dhe për të identifikuar mundësitë për përmirësim.

Për Fakultetin e Teknologjisë Ushqimore, monitorimi dhe vlerësimi i progresit është i domosdoshëm për të vlerësuar suksesin e aktiviteteve dhe për të siguruar se ato janë të lidhura ngushtë me nevojat e tregut të punës dhe kërkesat e industrisë ushqimore. Treguesit e performancës do të përdoren për të matur nivelin e arritjes së objektivave dhe për të siguruar që aktivizimi i aktiviteteve të planifikuara ka pasur ndikim pozitiv në cilësinë e mësimdhënies dhe kërkimeve shkencore.

Ky plan strategjik është i orientuar në përmirësimin e cilësisë në fushën e edukimit dhe kërkimit në teknologjinë ushqimore. Fakulteti synon të krijojë mundësi për zhvillimin e kurrikulave që i përgjigjen kërkesave të tregut dhe nevojave të industrisë ushqimore dhe mbrojtjes së mjedisit përmes një qasjeje inovative dhe të qëndrueshme. Në këtë mënyrë, studentët do të jenë të pajisur me njohuri dhe aftësi praktike që kërkohen nga sektori ushqimor, agrobiznesi dhe industria në përgjithësi.

Fakulteti i Teknologjisë Ushqimore është i angazhuar që përmes implementimit të këtij Plani Strategjik, të sigurojë një arsimim cilësor dhe të qëndrueshëm, duke ofruar mundësi për rritje profesionale dhe zhvillim të vazhdueshëm për studentët dhe fakultetin. Kjo do të

mundësojë që diplomantët të jenë të përgatitur për sfidat e industrisë ushqimore dhe për të kontribuar në zhvillimin e sektorëve të rinj dhe inovativë në këtë fushë.

Ky Plan Strategjik është një udhërrëfyes për të siguruar që Fakulteti i Teknologjisë Ushqimore të arrijë objektivat e tij afatshkurtra dhe afatgjata. Ky plan do të jetë gjithashtu një mjet për monitorimin e progresit dhe për vlerësimin e strukturave menaxhuese të Fakultetit, përmes rishikimit të vazhdueshëm të aktiviteteve dhe rezultateve të arritura. Implementimi i tij do të sigurojë që fakulteti të vazhdojë të përmirësohet dhe të zhvillohet, duke ofruar mundësi të reja dhe përgatitur studentët për një karrierë të suksesshme në fushën e teknologjisë ushqimore dhe mbrojtjes së mjedisit.